

## OSHEE, INVESTIM NË KANINË

Fshati i Kaninës është pjesë e paketës “100 Fshatrat” dhe tashmë kjo zonë përfiton furnizim më të mirë me energji elektrike, falë një investimi serioz të OSHEE. Ky investim ndikon edhe në rritjen e potencialeve turistike, duke ofruar mundësi për operatorët që ushtrojnë aktivitet në këtë zonë që të shtojnë kapacitetet e tyre. Me një investim prej 145 milionë lekësh u bë e mundur ndërtimi i 7 kabinave të reja, vendosja e mbi 100 shtyllave dhe shtrimi i 5 km kabull tensioni i ulët me ABC.

## KODIM DHE DESIGN THINKING

Përfundon faza e parë e shkollës verore “Shkenca Kompjuterike dhe Mentalitet Krijues”, gjatë së cilës 27 nxënës shqiptarë janë trajnuar dhe kanë punuar nën mentorimin e instruktorëve nga Stanford University SHBA. Ministria Balluku zhvilloi një takim me nxënësit pjesëmarrës dhe prindërit e tyre ku prezantoi projektin e MIE për t’a kthyer këtë shkollë në një institucion të përhershëm, duke zgjeruar kapacitetet e saj.

## PUNIMET NË RRUGËN E ARBËRIT

Rruga e Arbërit do jetë gati para afatit, pavarësisht problematikave të hasura gjatë zbatimit të projektit. Në të gjitha veprat e këtij aksi projekti po ecën me ritme të mira dhe punimet po kryhen me cilësi. Situata problematike është krijuar vetëm në tunelin e Murrizit, ku përbërja gjeologjike e nëntokës ka shkaktuar rrëshqitje duke krijuar vonesa në ecurinë e punimeve. Inxhinierët dhe specialistët janë duke punuar për gjetjen e një zgjidhjeje sa më optimale për këtë situatë.

## BUSHAT- VELIPOJË, RRJET I RI TENSIONI

Investim strategjik i OSHEE në zonën e Velipojës dhe nën Shkodrës, të cilat kanë tashmë një furnizim më të mirë me energji elektrike, në sajë të ndërtimit të rrjetit 110/20kV Bushat-Velipojë. Investimi përfshin ngritjen e 56 shtyllave të reja si dhe shtrirjen e 51 km përcjellës. Ky projekt i hap rrugë një tjetër projekti madhor për ngritjen e nënstacionit të ri.

## NDËRYRJE NË AKSIN LLOGARA- PALASË

Pas përfundimit të shtresës së konglomeratit, në segmentin rrugor, Llogara-Palasë, ka vijuar puna për montimin e bordurave të reja dhe betonimin e kunetave në këtë segment rrugor. Ndërhyrjet po bëhen jashtë trupit të rrugës duke mos u bërë pengesë për qarkullimin normal të automjeteve që kalojnë përmes këtij aksi.

## HEC FIERZË, RRITJE E SIGURISË

Ka përfunduar me sukses një tjetër investim në HEC Fierzë, me qëllim rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen nga rrëshqitjet, në shpatin e malit mbi tunelet e shkarkimit numër 3 dhe numër 4. Përgjatë gjithë perimetrit të shpatit të malit u vendosën barriera guri me strukture gabion, rrjeta mbrojtëse si dhe u krye pyllëzimi i shpatit.